

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, në përbërje të gjyqtarit të vetëm gjykues Violeta Namani, dhe pjesëmarrjen e Zyrtarës Ligjore Selvete Cakolli, në cilësi të procesmbajtëses, në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr. 7262/15, të datës 01.06.2016, kundër të pandehurve J. Sh. dhe B. Sh., nga Prishtina, të akuzuar për kryerjen e veprës penale Lëndim i Lehtë Trupor, në kundërshtim me nenin 188 par. 1 nën-par 1.4, të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor-dënim me gjobë, në pajtim me nenin 495 par 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, gjykata jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 31/08/2017, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr 7262/15, të datës 01.06.2016, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër

J. Sh., i biri i S. dhe S., e gjinisë M., i lindur me *data e lindjes...*, me vendbanim në rrugën "...", p.n. P., ku edhe jeton, pizza-man, i punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, me numër personal identifikues *numri personal...* shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

B. Sh., i biri i B. dhe H., e gjinisë K., i lindur me *data e lindjes...*, me vendbanim në rrugën "...", p.n. P., ku edhe tani jeton, i martuar, i punësuar, ka të kryer Fakultetin Juridik, i gjendjes ekonomike të mirë, me numër personal identifikue *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SEPSE

Me datën 03.12.2015 rreth orës 17:40, në rrugën "...", në ëmbëltoeren "B.", të pandehurit J. Sh. dhe B. Sh., pas një mosmarrëveshje të atëçastshme që kanë pasur me të dëmtuarin I. Gj. lidhur me pirjen e duhanit në lokal, i pandehuri J. Sh., nga mbrapa e ka goditur me boks në kokë, ndërsa i pandehuri B. Sh., e ka kapur për krahu dhe e ka rrëzuar për tokë, me ç'rast tani të dëmtuarit I. Gj., i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin-

-me këtë se cili veç e veç ka kryer veprën penale Lëndim i Lehtë Trupor, në kundërshtim me nenin 188 par 1, nën-par 1.4, të KPRK-së.

Në bazë të nenit 495 par 1 dhe të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës , gjykata i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë Euro)**, të cilin të dënuari **J. Sh.** obligohet ta paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre (3) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi- urdhri ndëshkimor.

Në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë Euro)**, të cilin të dënuari **B. Sh.** obligohet ta paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre (3) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi- urdhri ndëshkimor.

Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë ose nuk mundën ta paguajnë gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 € të gjobës.

Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të dënuarve, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzet (20) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë dyqind e katër dhjetë (240) orë.

Obligohen të pandehurit që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, për ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej pesëdhjet (20) euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej njëzet (20) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Pala e dëmtuar: Imer (Selma) Gjoka, me vendbanim në rrugën ‘Bajram Kelemendi’, nr 19, Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Me datën 01/06/2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, të identifikueshme me PP.II nr. 7262/2015, kundër të pandehurve J. Sh. dhe Burim Shehaj, për shkak të veprës penale Lëndim i Lehtë Trupor, në kundërshtim me nenin 188 par 1, nën-par 1.4, të KPRK-së dhe ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor-dënim me gjobë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ekzistojnë prova të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë kryerjen e veprës së pretenduar penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarve.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, Gjyqtari i vetëm gjykues, së pari, ekzaminoi nëse aktakuza, përkatësisht, kërkesa për dhënien e urdhërit ndëshkimor është e lejueshme, konform nenit 494 par 1 dhe 2 të KPPK-së.

Gjykata gjeti se aktakuza nuk përmban të meta formalo- juridike nga neni 494 të KPPK-së.

Pas shqyrtimit të shkresave të kësaj çështje penale juridike, gjykata gjithashtu konstatoi që kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjenë mbështetje në prova të besueshme dhe i plotëson të gjitha kushtet nga neni 493, të KPPK-së.

Nga shkresat e lëndës është vërtetuar që fillimisht i pandehuri J. Sh. e kishte goditur mbrapa me boks në kokë të dëmtuarit Imer Gjokaj dhe pastaj i pandehuri tjetër Burim Shehaj, e ka kapur atë për krahu dhe e ka rrëzuar për tokë, me ç'rast tani të dëmtuarit Imer Gjokaj, i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, siç edhe konstatohet në raportin e mjekësisë ligjore, të datës 05.05.2016. Incidenti derivoi si pasojë e një mosmarrëveshje të atëçastshme që të pandehurit kishin me të dëmtuarin Imer Gjokaj lidhur me pirjen e duhanit në lokal.

Në vendimin mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të pandehurve, gjykata kishte parasysh faktin që pala e dëmtuar kishte ndezur cigaren në vend ku ndalohet pirja e duhanit si faktor vendimtar i këtij incidenti, që megjithatë nuk përlligj veprimet e ndërmarra kundërligjshme të të pandehurve që përbëjnë vepër penale.

Provat e lartpërmendura të bashkangjitura aktakuzës, deklaratat e palëve të përfshira në këtë rast, raportet e policisë, si dhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilëve vërtetohet se të pandehurit janë penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale me të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi- Urdhri Ndëshkimor.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450, të KPPK.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 KPPK-së pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.2685/2016, datë 31/08/2017

Zyrtarja Ligjore,
Selvete Cakolli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Violeta Namani

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.